



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 81

Prishtinë, më 12.10.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Elheme Hetemi, Zef Morina, Berat Luzha, Heset Cakolli, Selvie Halimi, Ali Lajçi.

Munguan : Zulf Merxha, Myrvete Pantina, Branislav Grbić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës.**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 28.9.2010.**
3. **Sqarimi i ministrit të mjedisit rreth funksionalizimit të Bordit Mjedisor.**
4. **Shqyrtimi i projektligjit për ndryshim e plotësim të Ligjit për Blegtorin e Kosovës nr. 2004/33.**
5. **Draft propozimi për debatin dyditor për mjedis dhe bujqësi.**
6. **Te ndryshme.**

1. **Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** dhe propozoi të anulohet pika e pestë (5) për shkaqe të rrethanave të krijuara rreth mundësisë së mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, për çka komisioni nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 28.9.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me mundësi që **Elheme Hetemi** të inkorporoj në procesverbal atë çka duhet të qëndroj në të, nëse ka të bëjë me mbledhjen e kaluar.

VËREJTJE NGA STAFI : Vërejtja e deputetes ka të bëjë me një procesverbal të datës tjetër e cila është e miratuar më herët nga komisioni.

3. Funksionalizimi i Bordit Mjedisor

Naser Rugova falënderoj ministrin për prezencë dhe gatishmëri për të dhënë sqarime rreth jofunksionalizimit të Bordit Mjedisor dhe pa humbur kohë ja japi fjalën ministrit **Mahir Yagcillar** i cili arsyen kryesore për mosfunksionimin e bordit e sheh në mungesën e rregullores dhe statutit për funksionimin e bordit si dhe vështirësitë financiare, ndaj sugjeroj që ministria në një kohë të arsyeshme bashkërisht me drejtorinë e departamentit mjedisor dhe sekretarin të hartojnë dy dokumentet e cekura ndërsa me këtë komision të gjejnë rrugëdalje për vështirësitë financiare, duke kontaktuar rregullisht edhe me anëtarët e bordit.

Naser Rugova ishte i mendimit se ministri shumë qartë i dha qëndrimet e tija, mirëpo të kundërtën mendoj **Naim Maloku** i cili tha se “asgjë nuk është e qartë” sepse nuk dihet adresa dhe dita e funksionimit të bordit dhe pyeti : “pse i keni hy një pune nëse keni ditë që nuk ka kushte për zbatim”.

Mahir Yagcillar tha se për zbatimin e vendimit për bordin janë të involvuar dy institucionet : Kuvendi dhe Qeveria, prandaj gjithsesi duhet të krijohet baza ligjore e funksionalizimit (Rregullorja dhe Statuti si dhe çështja buxhetore), duhet të qartësohet cilat janë detyrat e Kuvendit dhe cilat të Qeverisë, ai premtoj se do të janë mjaft azhur në këtë drejtim dhe me përkrahje financiare (ndoshta për një muaj apo dy).

Selvie Halimi konstatoi se kemi të bëjmë me një organ këshillëdhënës profesional jo ekzekutiv që lehtëson punën e komisionit por edhe të ministrisë, ndaj në interesin e saj (ministrisë së mjedisit) është që të funksionoj ky bord me seli në MMPH, ngase Kuvendi është institucion politik. Ajo mendoj se nuk ka nevojë për statut por vetëm rregullore, si dhe të zgjidhet kryesuesi i bordit. Kompensimi është i rregulluar me ligj dhe nuk ka të bëjë me rregullore, ndërsa afatin është mirë që ministria ti caktoj vetes brenda së cilës do të hartoj rregulloren.

Naser Rugova u pajtua se kemi të bëjmë me zbatimin e ligjit (për Mjedisin) të cilin duhet ta bëjë MMPH me udhëzime apo akte tjera nënligjore sikurse çdo ligj tjetër, me një limit kohor.

Elhame Hetemi gjithashtu ishte i mendimit të ngjashëm sikurse parafolësit me konstatimin se me ligjin në fuqi nuk përcaktohet fondi funksionalizues, Bordi duhet të ketë rregulloren e punës ,sa i perket financimit edhe për këtë Bord le të perdoren praktikatat e financimit të Bordeve tjera ekzistuese. Në bashkëpunim me MMPH të gjindet një zyre për punë.

Behxhet Mustafa si anëtar i Bordit falënderoj për gatishmërinë e Komisionit parlamentar dhe MMPH për funksionalizimin e Bordit dhe shprehu gatishmërinë e të gjithë anëtarëve të Bordit për angazhimin madje urgjent, sepse si tha ai (tregoj një shembull) Banka ndërkombëtare asnjë projekt mjedisor nuk e përkrahë nëse nuk përcillet me VNM çka është obligim i këtij bordi, që jo vetëm të këshilloj, por dhe të monitoroj për të gjitha aktivitetet që kanë ndikim në mjedis.

Naim Maloku insistoi edhe një herë për kohën kur mundet të filloj bordi të punoj.

Zef Morina potencoi se shumë mirë dihet fakti kush zbaton një ligj, ndërsa lidhur me çështje buxhetore tha se buxheti i vitit 2010 është i miratuar, ndërkaq për vitin 2011 MMPH duhet të tregoj sa nevojiten për të funksionue bordi. Këtij komisioni i duhen këshilla, nëse ka nevojë ky komision mund të kërkoj edhe një fond të veçantë. Statuti dhe Rregullorja bëhen nga MMPH, përfundoi.

Berat Luzha tha se Këshilli Këshillëdhënës është vonuar me konstituim sikurse që janë vonuar edhe Këshilli i ujërave dhe Agjencia për rrezatime jonizuese, ndaj urgjentisht kërkoj angazhimin e ministrit në këtë drejtim. **Elhame Hetemi** sqaroi se Këshilli për ujëra është zëvendësuar tani me Këshillin ndërmjësor sipas projektligjit në procedurë, për çka ende është duke shqyrtuar grupi punues, ku është ajo.

Në emër të komisionit **Naser Rugova** nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Afati për konstituimin funksional të Bordit të Mjedisit caktohet afati 30 ditor, për çka ky komision do të angazhohet për verifikimin e konstituimit.
2. Rregullorja që do të hartohet nga ana e MMPH do të marr bekimin në këtë komision.
3. Ndarja buxhetore lidhur me këtë funksionalizim të bordit, do të bëhet nga ministria e mjedisit në pajtim me ligjin në fuqi.

4. Shqyrtimi i projektligjit për Blegtorinë

Naser Rugova konstatoi se komisioni lidhur me këtë projektligj ka angazhuar stafin për të ftuar kompetentët profesional nga Fakulteti i Bujqësisë për të dhënë fjalën duke mos caktuar grupin punues, ngase kemi të bëjmë me vetëm 7 nene për ndryshim dhe plotësim.

Isah Rudaku nga MB tha se ky projekt ka të bëjë me ndryshime që kanë të bëjnë me pengesa gjyqësore p.sh. fjala shkelje është zëvendësuar me kundërvajtje sepse gjykatat nuk e kanë zbatuar ligjin si dhe disa gabime tjera teknike e gjuhësore, poashtu është harmonizuar me dispozitat e BE.

Profesori Hajrip Mehmeti nga Fakulteti i bujqësisë tha se janë angazhuar për të analizuar këtë projekt, mirëpo kërkoj afat shtesë për shqyrtim. Dorëzoi disa vërejtje me shkrim.

Naim Maloku insistoi në urgjencën e kërkuar nga ana e kryesisë së Kuvendit që të procedohen projektligjet sa më shpejt, ndaj pasi që përfaqësuesi i fakultetit nuk ka vërejtje në projekt, tha se mirëseardhur do të ishte që vërejtjet në ligjin në fuqi për Blegtori të dërgohen më vonë për të kërkuar ky komision pastaj ndryshimin dhe plotësimin.

Naim Maloku dhe Berat Luzha ishin të mendimit se ky projekt mund të kaloj pa asnjë amendament për leximin e dytë dhe të inkorporohen vërejtjet e përfaqësuesit nga Fakulteti, mirëpo **Zef Morina** tha nëse dëshiron komisioni të miratoj vërejtjet e bëra nga profesori, duhet patjetër të miratohet së paku një amendament dhe projekti të dërgohet për leximin e dytë.

Selvie Halimi tha se komisioni përpunon vetëm nenet e projektligjit por jo edhe të atij në fuqi. **Isah Rudaku** tha se përfaqësuesi i fakultetit, me rastin e hartimit të projektligjit, nuk i ka thënë këto vërejtje, megjithatë këto vërejtje nuk prekin esencën e projektligjit dhe ligjit në fuqi

Naser Rugova si kryesues dhe me pajtimin e komisionit veptoi sipas sugjerimeve dhe nxori :

Amendament 1

Neni 1

Në nenin 1 të projektligjit në fillim shtohet : **Në nenin 1 pika a) në vend të “ruajtjen e racave origjinale” të shkruhet “ruajtjen e resurseve gjenetike vendore”.**

Në reshtin e 3 (tretë) fshihet **“dhe zookulturave”.**

Vërejtjet e përfaqësuesit të fakultetit lidhur me fjalën “cilësi” (kualitet), “shtesë” (aditiv) dhe dy shprehje tjera gjuhësore nuk hyjnë në këtë amendament ngase nuk janë të cekura në projektligj por në ligjin në fuqi.

Projektligji i dërgohet komisioneve të përhershme të Kuvendit të Kosovës për shqyrtim të mëtejme.

5. Te ndryshme

Në këtë pikë **Naser Rugova** sugjeroj të shqyrtohet memorandum i ofruar për bashkëpunim nga ana e OJQ BELLS-ATRC për çështjet mjedisore, të cilin duhet të nënshkruaj ai në emër të komisionit si kryesues, potencoi faktin se ky memorandum nuk është zyrtarisht detyrues për komisionin. Pavarësisht nga kjo **Selvie Halimi** pyeti a mund të veproi në këtë drejtim komisioni sipas rregullores së Kuvendit dmth të lidh marrëveshje me OJQ të ndryshme.

Naim Maloku sugjeroi që në emër të komisionit, kryetari i komisionit të angazhohet për nënshkrimin e memorandumit pas konsultimeve me departamentin ligjor të Kuvendit (Komisioni u pajtua). Kryetari **Naser Rugova** angazhoi koordinatoren e komisionit të konsultohet me departamentin ligjor lidhur me këtë memorandum të ofruar për nënshkrim nga ana e OJQ ATRC.

Zef Morina kërkoi nga komisioni të vendos lidhur me angazhimin e profesorit **Ali Shala** (aktualisht kryetar i Këshillit për ujëra) rreth projektligjit për Ujëra për pagesën e mëditjeve për aq ditë sa ka prezantuar në punën e grupit punues. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

OBLIGOHET Divizioni i Financave i Kuvendit të Kosovës, nga Fondi financiar i Komisionit për Bujqësi dhe Mjedis të paguaj Ali Shalës-profesor, 5 (pesë) mëditje nga 50,00 (pesëdhjetë) euro, aq sa ka prezantuar i njejti në takimet e grupit punues, gjithsejtë 250,00 (dyqindpesëdhjetë) euro.

Naser Rugova gjithashtu falënderoi dy ekspertët nga TAIEX-i të cilët prezantuan në mbledhjen e sotme dhe i ftoi të njëjtit të angazhohen në shqyrtimin e projektligjeve në procedurë. Staf i u angazhua që ti ftoi këta ekspert në shqyrtimin e projektligjit për ujëra. **Zef Morina** tha se mbledhja e grupit punues për projektligjin e ujërave do të mbahet në javën e ardhshme.

Mbledhja e radhës i komisionit caktohet për javën tjetër më 19 tetor, kur do të shqyrtohet projektligji i cili përfundon në grupin punues.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,40.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova